



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-029
Prishtinë, më 20 korrik 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 20 KORRIK 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Daut Haradinaj, Slavko Simić dhe Valdete Bajrami.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Driton Lajqi dhe Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe disa përfaqësues të organizatave dhe të Shoqërisë Civile dhe të tjerë, që i përcjellin punimet e Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy (2) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Më pas, Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 13 korrik 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 13 korrik 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 korrik 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari fillimisht i njoftoi anëtarët e Kryesisë se kanë mbetur edhe gjashtë (6) pika të papërfunduara nga Seanca plenare, e mbajtur më 16 korrik 2015.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e papërfunduara të Seancës së mëparshme, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të mërkurën, më 22 korrik 2015, në orën 14:00, me këtë:

Rend dite

5. Votimi i Projektligjit për Sigurimet,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale,
10. Kërkesa e deputetes Albulena Haxhiu, e mbështetur nga 5 deputetë nënshkrues për debat parlamentar lidhur me veprimtarin e misionit të BE-së në Republikën e Kosovës.

Më pas, Kryesia, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 23 korrik 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e Autorit dhe të drejtat e përafërta,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Armë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e rendit të ditës të propozuar për seancë plenare, Shqyrtimi i Propozim-amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që kanë të bëjnë me transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës, e heqi nga rendi i ditës.

3. Shqyrtimi i propozimeve, kërkesave dhe njoftimeve

1. Procedimi i Projektligjit për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me projektligjin e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij t'iu shpërndalet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqes raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

Pikat shtesë:

1. Kërkesa për ndihmë financiare për realizimin e himnit për nder të nobelistes dhe figurës kombëtare Gonxhe Bojaxhiu (Nëna Terezë)

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa nga Buxheti i Kuvendit, Kategoria Subvencione dhe Transfere, në shumën prej shtatëdhjetë mijë (70, 000) euro për mbështetjen e Projektit lidhur me realizimin e himnit për nder të nobelistes dhe figurës kombëtare Gonxhe Bojaxhiu (Nëna Terezë).
2. Shuma e mjeteve prej 30,000 euro (pjesa e parë) bartet tek Shoqata "Nëna Terezë" deri më 5 gusht 2015, ndërsa shuma prej 40,000 euro (pjesa e dytë) bartet, gjatë muajit shtator 2015, pas paraqitjes së raportit për përmbylljen e aktiviteteve.

2. Shqyrtimi i Propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, vendosi që për këtë çështje të diskutohet edhe njëherë në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, të cilën e caktoi të mbahet të mërkurën më 22 korrik 2015, në orën 10:00.

Të ndryshme:

Nënkryetari i Kuvendit z. Xhavit Haliti, ngriti çështjen e mos prezencës së deputetëve gjatë votimit të pikave të rendit të ditës në Seancë plenare. ?

Diskutimi i plotë i nënkryetarit të Kuvendit z. Xhavit Haliti, është dhënë në transkript.

Për çështjen e ngritur nga z. Haliti, diskutuan: Ismet Beqiri, Aida Dërguti, Adem Grabovci, Valdete Bajrami, Daut Haradinaj dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e ngritur nga z. Haliti, konstatoi që në fillim të çdo seance plenare, Kuvendi të deklarohet për kohën e votimit të pikave të rendit të ditës të cilat shqyrtohen në Seancë plenare.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 12:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale